

“Asnjë forcë politike në Kuvendin e Kosovës nuk ka të drejtë të vë kushte për themelimin e Forcës së Armatosur të Kosovës”.

Kështu ka deklaruar kryeministri i vendit, Hashim Thaçi, i cili në mbledhjen e Qeverisë sërisht u

bëri thirrje të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës që të hënë e ardhshme të votojnë

themelimin e Forcave të Armatosura të Kosovës.

“Ushtria e Kosovës është përtej interesave politike. Duke votuar për Forcat e Armatosura nuk

votohet për këtë apo atë individ, nuk votohet për Qeverinë e Kosovës, por votohet për shtetin e

Kosovës”, ka thënë kryeministri.

Ai sërish ka përsëritur që nëse brenda këtyre ditëve nuk votohet themelimi i Forcave të

Armatosura, atëherë do të ketë pasoja katastrofale për Ushtrinë e Kosovës.

“Themelimi i FAK-ut është domosdoshmëri, është shans historik për shtetin e Kosovës. Unë

dua të shpresoj që i gjithë spektri politik kosovar do të marr guximin dhe do të ketë kurajo që të

dalë mbi çdo interes të adresës së caktuar partiake të interesit ditor elektoral për të votuar në

mënyrë unike e konsensuale për themelimin e Ushtrisë së Kosovës. Mund të ketë zëra politik

që thonë se hajt shikojmë në mandatin e ardhshëm, por unë e them me përgjegjësi dhe

seriozitetin më të lartë para qytetarëve se nëse në ditët e ardhshme nuk ndodh votimi në

Kuvend, Kosova rrezikon formimin e FAK-ut me vite të tëra, prandaj këtë shans historik nuk

guxojmë ta humbim për asnjë interes të ngushtë politik”, ka thënë kryeministri në mbledhjen e

Qeverisë.

Qeveria e Kosovës, ndërkaq, ka miratuar edhe projekt-kornizën afatmesme të shpenzimeve për

vitet 2015-2017. Gjithashtu Qeveria ka miratuar propozim-vendimin për zotimin e qeverisë që të

marrë përsipër borxhet e mundshme nga marrëveshjet e vjetra në mes të ish-Federatës

jugosllave dhe qeverisë japoneze të cilat janë realizuar në territorin e Kosovës, raporton KTV.

Gjithashtu qeveria ka miratuar propozim-vendimin e politikave të qeverisë me qëllim të ofrimit të

lehtësirave tatimore për investimet e reja. /Indeksonline